



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.208

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1705, datë 29.12.2008	Për miratimin e rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografikë	11157
Vendim i KM nr.1708, datë 29.12.2008	Për zbatimin e programeve për ruajtjen In-situ të racave autoktone të bagëtive të imëta	11176
Vendim i KM nr.1709, datë 29.12.2008	Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes bashkisë Sarandë të sipërfaqes 10 000 (dhjetë mijë) m ² , pjesë e pronës nr.696 “Baza ndihmuese”, Sarandë dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes	11177
Vendim i KM nr.1710, datë 29.12.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.502, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar”	11178
Udhëzim i MPPTT nr.23, datë 30.12.2008	Për përmbajtjen e bonusit të strehimit	11179
Vendim i GJK nr.29, më 29.12.2008	Me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Gjergj Sauli.....	11182
Kërkesë e MPPTT nr.8719/1, datë 30.12.2008	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Korçë” Loti II	11183

VENDIM
Nr.1705, datë 29.12.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIMIN E TREGUESVE GJEOGRAFIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 177,180,182 e 202 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore "Për regjistrimin e treguesve gjeografikë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Urdhri nr.5, datë 5.12.1994 i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë "Rregulla për emërtimet e origjinës", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR REGJISTRIMIN E TREGUESVE GJEOGRAFIKË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

1.1 Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me:

a) paraqitjen e aplikimeve për regjistrimin e treguesve gjeografikë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe shqyrtimin e tyre nga DPPM;

b) paraqitjen dhe shqyrtimin e kundërshtimeve dhe apelimeve në Bordin e Apelit të DPPM lidhur me treguesit gjeografikë;

c) publikimin e të dhënave lidhur me treguesit gjeografikë në Buletin e Pronësisë Industriale nga DPPM.

2. Përkufizime

2.1 Në zbatim të kësaj rregulloreje, termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) Emërtimi i origjinës është emri i një vendi, rajoni ose lokaliteti që shërben për të përcaktuar produktet që e kanë origjinën në atë vend, cilësitë, fama ose karakteristikat e tjera të cilave vijnë si rezultat i mjedisit gjeografik, faktorëve natyrorë dhe njerëzorë ose si rezultat i prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes së produkteve në këtë zonë të veçantë gjeografike.

b) Tregues gjeografik është emri i një vendi, rajoni ose lokaliteti që shërben për të përcaktuar produktet që e kanë origjinën në atë vend, cilësia, reputacioni dhe karakteristikat e të cilit janë atribut i kësaj origjine gjeografike.

c) Ligji nënkupton ligjin nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".

3. Parime të përgjithshme

3.1 Të drejtën për të aplikuar pranë DPPM për regjistrimin e një treguesi gjeografik e ka çdo person fizik ose juridik që prodhon, përpunon ose përgatit në një zonë të caktuar gjeografike produktin, për përcaktimin e të cilit përdoret treguesi gjeografik.

3.2 DPPM shqyrton aplikimet e depozituara dhe lëshon njoftimet dhe aktet e tjera, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

3.3 Veprimet e DPPM-së lidhur me këto aplikime bazohen ekskluzivisht në dokumente të shkruara. Kërkesat dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër që depozitohet pranë DPPM-së duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të shtypura.

3.4 DPPM-ja krijon dhe administron bazën elektronike të të dhënave, ku ruhen të gjitha veprimet e kryera në lidhje me treguesit gjeografikë.

4. Llojet e aplikimeve

4.1 Llojet e aplikimeve që mund të depozitohen pranë DPPM-së lidhur me treguesit gjeografikë janë:

- a) Kërkesë për regjistrimin e treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTG1 (aneksi 1 i rregullores);
- b) Kërkesë për ndryshimin e emrit të pronarit të treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTG2 (aneksi 1 i rregullores);
- c) Kërkesë për ndryshimin e adresës së pronarit të treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTG3 (aneksi 1 i rregullores);
- ç) Kërkesë për dorëheqje nga treguesi gjeografik i regjistruar, nëpërmjet formularit FTG4 (Aneksi 1 i rregullores);
- d) Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik të publikuar, nëpërmjet formularit FTG5 (aneksi 1 i rregullores);
- dh) Kërkesë për apelimin e vendimit të DPPM për refuzimin e aplikimit, nëpërmjet formularit FTG6 (aneksi 1 i rregullores).

KREU II

PARAQITJA E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E TREGUESIT GJEOGRAFIK

1. Paraqitja e aplikimit

1.1 Aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet nëpërmjet formularit FTG1, i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij dhe depozitohet pranë protokollit të DPPM-së. Formulari FTG1 mund t'i dërgohet DPPM-së edhe me postë ose me faks nga paraqitësi i kërkesës, ose përfaqësuesi i tij. Në rastin e dërgimit me faks, aplikanti duhet që, brenda një muaji nga data e dërgimit të faksit, të depozitojë pranë DPPM-së kërkesën në formën e saj origjinale, në të kundërt kërkesa konsiderohet si e paparaqitur.

1.2 Dosja e aplikimit shoqërohet me listën e dokumenteve të depozituara (indeksi i dosjes), e cila nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij.

1.3 Aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet në lidhje me një produkt të vetëm.

1.4 Zyra e protokollit të DPPM-së, ditën që merr në dorëzim formularin FTG1 për regjistrimin e një treguesi gjeografik, shënon mbi formular datën dhe orën e paraqitjes së kërkesës, si dhe numrin e kërkesës.

2. Elementet thelbësore që përmban aplikimi

2.1 Në zbatim të nenit 182 të ligjit, aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik duhet të përmbajë:

a) formularin FTG1 të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij, i cili duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë të dhënat mbi emrin dhe adresën e aplikantit, treguesin gjeografik, përcaktimin e produktit për të cilin do të përdoret treguesi gjeografik, si dhe përcaktimin e kufijve të lokalitetit gjeografik, ku prodhohet ose përpunohet produkti;

b) dokumentin e pagesës së tarifës së depozitimit;

c) një raport mbi vetitë dhe karakteristikat e produktit dhe lidhjen e tij me mjedisin e origjinën gjeografike;

ç) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton kufijtë e zonës gjeografike, ku prodhohet ose përpunohet produkti;

d) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton vetitë dhe karakteristikat e produktit, si dhe lidhjen ndërmjet vetive dhe karakteristikave të produktit me mjedisin gjeografik ose origjinën gjeografike, në përputhje me parashikimin e pikës 2 të nenit 177 të ligjit;

dh) një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë;

e) kur aplikanti është një person fizik ose juridik i huaj, dokumentin që vërteton regjistrimin e treguesit gjeografik në vendin e origjinës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar;

ë) kur produkti është ushqimor ose bujqësor, një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, i cili vërteton se produkti i përmbush të gjitha kriteret mbi cilësinë, të parashikuara nga legjislacioni përkatës në fuqi;

f) autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit. Autorizimi i

përfaqësimit duhet të përmbajë nënshkrimin e aplikantit, dhe kur aplikanti është person juridik, edhe vulën e tij.

KREU III EKZAMINIMI FORMAL I KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E TREGUESIT GJEORAFIK

1. Rendi dhe afatet e ekzaminimit të aplikimit

1.1 Kërkesat për regjistrimin e treguesve gjeografikë ekzaminohen nga DPPM-ja sipas radhës së paraqitjes së tyre.

1.2 Një kërkesë ekzaminohet jashtë radhës, nëse ekziston një konflikt rreth shkëlqes së të drejtave të treguesit gjeografik. Ekzaminimi jashtë radhës bëhet nga ekzaminuesi pasi aplikanti të paraqesë një kërkesë me shkrim dhe të paguajë tarifën përkatëse.

1.3 Ekzaminimi i aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet brenda periudhës 3- (muajore) nga data e paraqitjes së tij. Brenda kësaj periudhe ekzaminuesi shqyrton nëse aplikimi plotëson kushtet e nenit 182 të ligjit dhe pikës 2 të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ekzaminimi i aplikimit dhe njohja e datës së depozitimit

2.1 Nëse aplikimi i përmbush të gjitha kërkesat e nenit 182 të ligjit dhe të pikës 2 të kreut II të kësaj rregulloreje, DPPM-ja bën depozitimin e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit, duke njohur si datë depozitimi datën e paraqitjes së aplikimit.

2.2 Nëse aplikimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e nenit 182 të ligjit dhe të pikës 2 të kreut II të kësaj rregulloreje, DPPM-ja njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Periudha për paraqitjen e plotësimeve mund të zgjatet deri në 1 muaj shtesë, nëse aplikanti paraqet me shkrim një kërkesë bazuar në shkaqe të arsyeshme dhe kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Në çdo rast, kërkesa për zgjatjen e afatit duhet të depozitohet pranë DPPM-së, pa mbaruar afati tremujor i caktuar për plotësimin e të metave të aplikimit.

2.3 Kur aplikanti i kryen plotësimet e kërkuara brenda kohës së caktuar, DPPM-ja depoziton aplikimin dhe i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit brenda 3 muajve nga data kur aplikanti ka plotësuar të metat e kërkesës, duke njohur si datë depozitimi të aplikimit datën e paraqitjes së tij.

2.4 Kur të metat e aplikimit kanë të bëjnë me emrin dhe adresën e aplikantit, treguesin gjeografik, produktin për të cilin regjistrohet treguesi ose me mospagesën e tarifës së depozitimit, datë depozitimi e aplikimit do të njihet data e plotësimit të të metave. Në rastin kur të metat lidhur me ndonjë prej elementeve të lartpërmendura konsistojnë në gabime të tilla që nuk cenojnë thelbin e këtyre elementeve, si datë depozitimi e kërkesës do të njihet data në të cilën aplikimi është paraqitur pranë DPPM-së.

2.5 Nëse aplikanti nuk i kryen plotësimet brenda afatit të caktuar, DPPM-ja e refuzon kërkesën për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe i lëshon aplikantit njoftimin e refuzimit të aplikimit.

3. Dëshmia e depozitimit

3.1 Dëshmia e depozitimit përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e treguesit gjeografik;
- b) emrin dhe adresën e aplikantit;
- c) datën e depozitimit dhe numrin e kërkesës;
- ç) produktin për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

KREU IV EKZAMINIMI I APLIKIMIT NË LIDHJE ME BAZAT E REFUZIMIT DHE REGJISTRIMI I TREGUESIT GJEORAFIK

1. Ekzaminimi në lidhje me shkaqet absolute për refuzim

1.1 Pas njohjes së datës së depozitimit, ekzaminuesi, brenda një periudhe tremujore nga data e lëshimit të dëshmisë së depozitimit, ekzaminon nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e e germave “a” dhe “b” të nenit 180 të ligjit.

1.2 Gjatë ekzaminimit, DPPM-ja mund t’i kërkojë aplikantit materiale dhe dokumente shtesë nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Aplikanti duhet t’ia paraqesë DPPM-së dokumentet e kërkuara, brenda 2 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet përfundimisht dhe paraqitësi i kërkesës njoftohet për refuzimin nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku paraqiten dhe arsyet e refuzimit të kërkesës.

1.3 Kur nga ekzaminimi i aplikimit rezulton se ai bie në kundërshtim me kërkesat e germave “a” dhe “b” të nenit 180 të ligjit, DPPM-ja e refuzon atë dhe njofton aplikantin nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku paraqiten arsyet e refuzimit të kërkesës.

2. Regjistrimi i treguesit gjeografik

2.1 Nëse brenda 3 muajve nga data e publikimit të aplikimit asnjë kundërshtim nuk është depozituar nga palët e treta kundër regjistrimit të treguesit gjeografik, DPPM-ja nxjerr njoftimin për pagesën e tarifës së regjistrimit dhe i kërkon aplikantit që, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit, të bëjë pagesën e tarifës dhe një kopje të dokumentit të pagesës ta depozitojë pranë DPPM-së.

2.2 Nëse aplikanti nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar, DPPM-ja refuzon aplikimin dhe njofton me shkrim aplikantin.

2.3 Kur aplikanti e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar, DPPM-ja e regjistron treguesin gjeografik në regjistrin përkatës dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një periudhe tremujore nga data e pagesës së tarifës.

2.4 DPPM-ja publikon treguesin gjeografik të regjistruar në Buletin e Pronësisë Industriale.

3. Të dhënat që përmban certifikata e regjistrimit të treguesit gjeografik

3.1 Certifikata e regjistrimit të treguesit gjeografik duhet të përmbajë:

- a) emërtimin e treguesit gjeografik;
- b) emrin dhe adresën e pronarit të treguesit gjeografik;
- c) numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të tij;
- ç) datën e depozitimit dhe datën e regjistrimit;
- d) produktin për të cilin është regjistruar treguesi gjeografik.

4. Kryerja e ndryshimeve ose heqja dorë nga aplikimi

4.1 Kur aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik është në proces ekzaminimi dhe ka ndodhur ndryshimi i emrit dhe/ose adresës së aplikantit, DPPM-ja kundërshton depozitimin nga aplikanti të formularit përkatës, dokumenteve që provojnë ndryshimin e mësipërm dhe pagesës së tarifës përkatëse, e regjistron treguesin në regjistrin e treguesve gjeografikë me të dhënat e reja, pa ndryshuar datën e depozitimit të aplikimit.

4.2 Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, për aq kohë sa ai nuk është regjistruar ende në regjistrin e treguesve gjeografikë. Me depozitimin e një kërkesë të tillë, aplikimi konsiderohet i tërhequr.

KREU V

PUBLIKIMET NË BULETININ E PRONËSISË INDUSTRIALE

1. Llojet e publikimeve

1.1 DPPM-ja publikon në Buletin e Pronësisë Industriale të dhënat mbi aplikimin për regjistrimin e treguesit gjeografik, regjistrimin e tij, ndryshimet në emrin dhe/ose adresën e pronarit të treguesit gjeografik, dorëheqjen dhe shfuqizimin e treguesit gjeografik.

2. Publikimi i aplikimeve dhe regjistrimeve të treguesve gjeografikë

2.1 Të dhënat që publikohen në Buletin për aplikimin janë:

- a) numri i kërkesës;
- b) data e depozitimit;
- c) emri dhe adresa e aplikantit;
- ç) emërtimi i treguesit gjeografik;
- d) produkti për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

2.2 Të dhënat që publikohen në Buletin për regjistrimin e treguesit gjeografik janë:

- a) numri i kërkesës dhe numri i regjistrimit;
- b) data e depozitimit;
- c) emri dhe adresa e aplikantit;
- ç) emërtimi i treguesit gjeografik;
- d) produkti për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

KREU VI

KUNDËRSHTIMI PËR REGJISTRIMIN E TREGUESIT GJEOGRAFIK

1. Paraqitja e kundërshtimit

1.1 Kundërshtimi ndaj një aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik të publikuar, mund të paraqitet pranë DPPM-së, brenda një periudhe tremujore nga data e publikimit, për një nga shkaqet e parashikuara në germën "c" dhe "ç" të nenit 180 të ligjit ose për çdo shkak tjetër të ligjshëm, nëpërmjet depozitimit të dokumenteve të mëposhtme:

- a) formulari FTG5 për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik;
- b) dokumentin e pagesës së tarifës për kundërshtimin.

1.2 Kundërshtimi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) autorizimin e përfaqësimit, në rast se kundërshtimi paraqitet nga përfaqësuesi i kundërshtuesit;
- b) dokumentet mbi të cilat kundërshtuesi bazon pretendimet e tij.

2. Shqyrtimi i kundërshtimit nga bordi i apelimit

2.1 Bordi i apelimit të DPPM-së e shqyrton kundërshtimin dhe merr vendim lidhur me të brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së tij.

2.2 Në rast se kundërshtimi nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga pika 1.1 e këtij kreu, bordi i apelimit e konsideron të paparaqitur kundërshtimin dhe njofton me shkrim kundërshtuesin.

2.3 Në rast se kundërshtimi nuk plotëson kërkesat e pikës 1.2 të këtij kreu, bordi i apelimit i kërkon kundërshtuesit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të plotësojë të metat brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, në të kundërt kundërshtimi quhet si i paparaqitur.

2.4 Kur kundërshtimi i plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, bordi i apelimit pranon për shqyrtim kundërshtimin dhe njofton me shkrim aplikantin e treguesit gjeografik kundër të cilit është depozituar kundërshtimi, duke i kërkuar atij që, brenda një muaji nga data e njoftimit, të depozitojë me shkrim pretendimet e tij lidhur me kundërshtimin dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të pretendimeve të tij.

2.5 Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë brenda një periudhe njëmuajore nga data e njoftimit.

2.6 Bordi i apelimit merr vendim lidhur me kundërshtimin dhe njofton me shkrim palët. Vendimi i bordit të apelimit mund të apelohej në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Trajtimi i aplikimit pas marrjes së vendimit mbi kundërshtimin

3.1 Kur bordi i apelimit vendos të rrëzojë kundërshtimin dhe vendimi nuk apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën e regjistrimit, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

3.2 Kur bordi i apelimit vendos të pranojë kundërshtimin dhe vendimi nuk apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminuesi lëshon njoftimin e refuzimit të regjistrimit.

3.3 Në rast se vendimi i bordit të apelimit lidhur me kundërshtimin për regjistrimin e një treguesi gjeografik apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit dhe DPPM-ja refuzon ose regjistron treguesin gjeografik, në përputhje me vendimin e gjykatës.

KREU VII

NDRYSHIMI I EMRIT DHE/OSE ADRESËS SË PRONARIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Pronari i një treguesi gjeografik mund të kërkojë ndryshimin e emrit dhe/ose adresës së tij në regjistrin e treguesve gjeografikë. Kërkesa për ndryshimin e emrit paraqitet pranë DPPM-së, nëpërmjet formularit FTG2 dhe kërkesa për ndryshimin e adresës paraqitet nëpërmjet formularit FTG3.

1.2 Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të treguesit gjeografik;

c) në rastin kur kërkohet ndryshimi i emrit, dokumentin që vërteton këtë ndryshim.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja

2.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për ndryshim emri ose adrese, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu dhe në rast ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 DPPM-ja e regjistron ndryshimin e emrit ose adresës së pronarit të treguesit gjeografik në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe njofton aplikantin për regjistrimin e ndryshimit, brenda 6 muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu. Ndryshimi publikohet në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU VIII

REGJISTRIMI I DORËHEQJES NGA TREGUESI GJEOGRAFIK

1. Paraqitja e kërkesës
- 1.1 Kërkesa për regjistrimin e dorëheqjes nga treguesi gjeografik i regjistruar, paraqitet pranë DPPM-së nëpërmjet formularit FTG4 nga pronari i treguesit gjeografik.
- 1.2 Së bashku me formularin, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
 - b) autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të treguesit gjeografik.
2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja
- 2.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për dorëheqje, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij Kreu dhe në rast ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.
- 2.2 DPPM-ja e regjistron dorëheqjen nga treguesi gjeografik në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe njofton aplikantin për regjistrimin e dorëheqjes, brenda 6 muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu. Dorëheqja publikohet në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU IX

APELIMET PRANË BORDIT TË APELIMIT

1. Paraqitja e apelimit
- 1.1 Brenda një periudhe dymujore nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e një aplikimi, aplikanti ka të drejtë të apelojë vendimin e DPPM-së në bordin e apelimit, duke depozituar pranë DPPM-së:
 - a) formularin e apelimit FTG6, të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij;
 - b) dokumentin e pagesës së tarifës për apelimin;
 - c) autorizimin e përfaqësimit nëse apelimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.
2. Shqyrtimi i apelimit nga bordi i apelimit të DPPM
- 2.1 Bordi i apelimit shqyrton paraprakisht nëse apelimi përmbush kërkesat e pikës 1.1 të këtij kreu dhe nëse këto kërkesa nuk janë përmbushur, bordi i apelimit njofton me shkrim apeluesin se kërkesa e tij konsiderohet e paparaqitur.
- 2.2 Kur kërkesa për apelim përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, bordi i apelimit e shqyrton kërkesën për apelim brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë. Apeluesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatë vendimin e bordit të apelimit që merret mbi një refuzim të bërë në bazë të germës “a” dhe “b” të nenit 180 të ligjit. Vendimet e bordit në lidhje me apelimet e tjera të parashikuara nga kjo rregullore dhe nga ligji janë të formës së prerë.
- 2.3 Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë t’i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe njëmujore nga data e njoftimit.
3. Trajtimi i aplikimit pas marrjes së vendimit mbi apelimin
- 3.1 Kur bordi i apelimit vendos të pranojë apelimin dhe vendimi nuk apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për regjistrimin e tij, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
- 3.2 Kur bordi i apelimit vendos të rrëzojë apelimin dhe vendimi nuk apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe refuzimi merr formë të prerë.
- 3.3 Në rast se vendimi i bordit të apelimit apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe DPPM-ja e refuzon ose e regjistron atë në përputhje me vendimin e gjykatës.

KREU X

DOKUMENTE TË TJERA QË LËSHON DPPM-JA LIDHUR ME TREGUESIT GJEOGRAFIKË

1. Ekstaktet dhe hetimet e lëshuara nga regjistri i treguesve gjeografikë
- 1.1 Në zbatim të nenit 192 paragrafi 2 dhe 194 të ligjit, DPPM-ja u lëshon personave të interesuar ekstrakte nga regjistri i treguesve gjeografikë, si dhe përgjigje të kërkesave për hetim.
- 1.2 Kërkesa për ekstrakt regjistri për një tregues gjeografik të regjistruar paraqitet pranë DPPM-së me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e

paparaqitur. Ekstrakti i regjistrit lëshuar nga DPPM-ja përmban të gjitha të dhënat mbi treguesin gjeografik dhe historikun e ndryshimeve që ka pësuar ai.

1.3 Kërkesa për hetim në lidhje me një tregues gjeografik paraqitet pranë DPPM me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. DPPM-ja njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës lidhur me rezultatin e hetimit.

2. Dublikatat dhe dokumenti i prioritetit

2.1 Pronari i një treguesi gjeografik të regjistruar ka të drejtë të kërkojë dublikatë të certifikatës së regjistrimit ose të njoftimeve të tjera të lëshuara nga DPPM-ja për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e treguesve gjeografikë. Kërkesa depozitohet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me dokumentin e pageses së tarifës përkatëse, si dhe me autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të treguesit gjeografik, në të kundërt ajo konsiderohet e paparaqitur.

3. Korrigjimi i akteve nga DPPM-ja

3.1 Në rastin e lëshimit nga DPPM-ja të akteve, që përmbajnë gabime ose pasaktësi, jo për fajin e aplikantit ose pronarit të treguesit gjeografik, korrigjimi i tyre bëhet nga DPPM-ja në bazë të një kërkesë me shkrim të paraqitur nga aplikanti ose pronari i treguesit gjeografik. DPPM-ja e rilëshon aktin të korrigjuar, pasi aplikanti ose pronari i treguesit gjeografik ka dorëzuar pranë DPPM origjinalin e aktit për të cilin kërkohet korrigjimi, bën pasqyrimin e korrigjimit në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe e publikon atë në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KËRKESË PËR REGJISTRIM TREGUESI GJEORAFIK

 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë Tel: +355 42 363 681, Fax: +355 4 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al	<i>rezervuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i> referenca: nr i prot:
--	---

1 PARAQITËSI I KËRKESËS a) Emri: b) Adresa: (Kodi postar/Qyteti/Shteti) c) Adresa për korrespondence: (nëse është e ndryshme nga me sipër) d) Telefon : Fax: E-mail: e) Statusi Ligjori:

2 PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR (ne rast se ka) Emri: Adresa: Telefon: Fax: E-mail: <i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licencuar nga Drejtoria)</i> Kodi i përfaqësuesit të autorizuar:

3 TREGUESI GJEORAFIK Shënoni me poshtë treguesin gjeografik për të cilin kërkohet mbrojtja.....
--

4

RAJONI GJEOGRAFIK

Shënoni me poshtë territorin e vendit, rajonin, apo lokalitetin ku prodhohet ose përpunohet produkti

.....

.....

5

CILËSIA, REPUTACIONI APO KARAKTERISTIKA TË TJERA

Cilësia, reputacioni apo karakteristika të tjera të mallrave për të cilat treguesi gjeografik është përdorur të tregohen me poshtë:

.....

.....

.....

☐ Vazhdoni në faqen shtesë.

6

LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS

Tarifa baze për tregues gjeografik (----- leke)

Lloji i dok. të pagesës

dd/mm/vvvv

(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa:
Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe
Markave

----- në çdo Bankë)

Totali i shumës së paguar

7

(a) Shënoni më poshtë produktet:

[illegible]

☐ Lista e produkteve vazhdon ne fagen shtese.

8

Emër/Mbiemër *Data:* (dd/mm/yyyy)

Nënshkrimi:

KËRKESË PËR NDRYSHIM EMRI TË PRONARIT ose APLIKANTIT TË TREGUESIT GJEORAFIK

 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë Tel: +355 42 363 681, Fax: +355 4 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al	<i>reservuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i> referenca: nr i prot:
--	---

1	TË DHENA PËR TREGUESIN GJEORAFIK NUMRI I KËRKESËS..... NUMRI I REGJISTRIMIT (nëse ka)..... DATA E DEPOZITIMIT DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT (nëse ka)
----------	---

2	EMRI DHE ADRESA E PRONARIT/APLIKANTIT (Ashtu si është shënuar në regjister/formular) Emri : Adresa:
----------	---

3	EMRI I <u>RI</u> I PRONARIT/APLIKANTIT
----------	---

4	PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR (në rast se ka të tillë) Emri: Adresa: Telefon:..... Fax: E-mail: <i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licencuar nga DPPM)</i> Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar:
----------	---

5

LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS

☐ **Tarifa** per ndryshimin e emrit ----- lekë

dd/mm/vvvv

Lloji pagesës:

.....
(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës se thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave
----- në çdo Bankë)

6

NËNSHKRIMI I PRONARIT / APLIKANTIT / PËRFAQËSUESIT - DATA

Emër/Mbiemër:Data: (dd/mm/vvvv)

Nënskrimi:.....

KËRKESË PËR NDRYSHIM ADRESE TË PRONARIT ose APLIKANTIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK

 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë Tel: +355 4 2 362 451, Fax: +355 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al	<i>re:ervuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i> referenca: nr i prot:
---	---

1	TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK NUMRI I KËRKESËS NUMRI I REGJISTRIMIT (nëse ka) DATA E DEPOZITIMIT DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT (nëse ka)
----------	--

2	EMRI DHE ADRESA E PRONARIT/APLIKANTIT <i>(Ashtu si është shënuar ne regjistër/formular)</i> a) Emri: b) Adresa: <i>(Kodi postar/Qyteti/Shiteti)</i>
----------	---

3	ADRESA E RE E PRONARIT/APLIKANTIT ☐ Adresa e re : Tel: Fax: Adresa e-mailit:
----------	---

4**ADRESA PËR KORESPONDENCË**

(kur është e ndryshme nga ajo e rubrikës 3)

.....

.....

.....

.....

.....

5**PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR** (ne rast se ka te tillë)

Emri:

Adresa:

.....

Telefon:..... Fax:

E-mail:

.....

(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPM)

Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar:

6**LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS**

☐ **Tarifa** për ndryshimin e adresës ----- lekë

Data e pageses:dd/mm/vvvv

Lloji pagesës:

.....

(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës se thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave

----- në çdo Bankë)

7**NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA**

Emër/Mbiemër..... *Data:*..... (dd/mm/vvvv)

Nënshkrimi:.....

KËRKESË PËR DORËHEQJE NGA TREGUESI GJEOGRAFIK I REGJSTRUAR

	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D' Ark. Nr. 3, Tiranë Tel: +355 42 362 451, Fax: +355 4 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al	<i>reservuar per Zyren/te mos plotesohet nga aplikanti</i> referenca: nr i prot:
---	---	--

1 TË DHËNA PËR TREGUESIN GJEOGRAFIK

NUMRI I KËRKESËS

NUMRI I REGJISTRIMIT (nëse ka)

DATA E DEPOZITIMIT

DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT (nëse ka)

2 EMRI DHE ADRESA E PRONARIT *(Ashtu si është shënuar në regjister)*

a) Emri:

b) Adresa:

.....

(Kodi postar/Qyteti/Shteti)

3 PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR *(në rast se ka të tillë)*

Emri:

Adresa:

.....

Telefon: Fax: E-mail:

(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPM)

Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar:

4 LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS

Tarifa për dorëheqjen e treguesit gjeografik ----- leke

Lloji pagesës: dd/mm/vvvv

(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave në çdo Bankë)

5 NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA

Emër/Mbiemër *Data:* (dd/mm/vvvv)

Nënshkrimi:

KËRKESË PËR KUNDËRSHTIMIN E REGJISTRIMIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK TË PUBLIKUAR

 DREJTORIA E PERGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë Tel: +355 4 2 362 451, Fax: +355 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al	<i>reservuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i> referenca: nr i prot:
--	---

1 TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK

NUMRI I KËRKESËS

DATA E DEPOZITIMIT

NUMRI DHE DATA E PUBLIKIMIT

2 EMRI DHE ADRESA E APLIKANTIT

a) Emri:

.....

b) Adresa

3 TË DHËNA LIDHUR ME KUNDËRSHTUESIN E RREGJISTRIMIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK TË PUBLIKUAR

a) Emri:

b) Adresa:

.....

c) Tel: Fax:

d) E-mail:

4

PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR *(ne rast se ka te tille)*

Emri:

Adresa:

.....

Telefon:..... Fax:

E-mail:

(plotësohet vetem nga përfaqësuesit e licencuar nga DPPM)

Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar:

6

LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS

☐ Tarifa për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik ----- lekë

dd/mm/vvvv

Lloji pagesës:

.....
*(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës se thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave
----- në çdo Bankë)*

6

NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA

Emër/Mbiemër *Data:* (dd/mm/vvvv)

Nënshkrimi:

KËRKESË PËR APELIN E VENDIMIT TË REFUZIMIT TË APLIKIMIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK

 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë Tel: +355 4 2 362 451, Fax: +355 2 234 412 Email: mailinf@aloto.gov.al	<i>rezervuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i> referenca: nr i prot:
--	---

1 TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK

NUMRI I KËRKESËS

DATA E DEPOZITIMIT

DATA E REFUZIMIT TE APLIKIMIT.....

2 EMRI DHE ADRESA E APELUESIT

a) Emri:

.....

b) Adresa

.....

3 PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR *(ne rast se ka te fille)*

Emri:

Adresa:

.....

Telefon:..... Fax:

E-mail:

(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licencuar nga DPPM)

Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar:

4 LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS

Tarifa për apelimin e vendimit te refuzimit te aplikimit te treguesit gjeografik ----- leke

Lloji pagesës:	dd/mm/vvvv
..... (Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave në çdo Bankë)	
5 NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA	
Emër/Mbiemër: Data: (dd/mm/vvvv)	
Nënshkrimi:	

VENDIM
Nr.1708, datë 29.12.2008

PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE PËR RUAJTJEN IN-SITU TË RACAVE AUTOKTONE TË BAGËTIVE TË IMËTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 60 të ligjit nr.9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 10 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Programet për ruajtjen *In-situ* të racave autoktone të bagëtive të imëta zbatohen për ato raca dhe/ose ekotipe, të cilat shpallen “Raca/ekotipe në gjendje kritike për t’u zhdukur”, sipas përcaktimit të aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngritjen, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të komisionit të vlerësimit për gjendjen dhe nivelin e rrezikut të zhdukjes në racat/ekotipet autoktone të bagëtive të imëta. Veprimtaria e këtij komisioni përcaktohet me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Ngritjen, në drejtorinë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, të komisionit të identifikimit të racave/ekotipeve të bagëtive të imëta në rrezik për t’u zhdukur, i cili të drejtohet nga inspektori i zooteknisë.

4. Një ndër hallkat kryesore të programeve për ruajtjen *In-situ* të racave dhe/ose ekotipeve autoktone të bagëtive të imëta, të shpallura “Raca/ekotipe në gjendje kritike për t’u zhdukur”, është zbatimi i pagesës, një herë në vit, i fermerëve, që janë pronarë të tufave, që do të përfshihen në këto programe.

5. Masa e pagesës të jetë: 2 000 (dy mijë) lekë për riprodhues femër dhe 3 000 (tre mijë) lekë për riprodhues mashkull, të matrikulluar. Kjo pagesë zbatohet jo më pak se 4 vjet për çdo racë/ekotip, të shpallur “Racë/ekotip në gjendje kritike për t’u zhdukur”. Pagesa ndërpritet me shpalljen e vendimit për kapërcimin e gjendjes kritike për t’u zhdukur.

Për realizimin e kësaj pagese, në Buxhetin e Shtetit të parashikohen, çdo vit, 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NIVELI I RREZIKSHMËRISË PËR T'U ZHDUKUR
(numri i riprodhuesve femra në popullatë)

Niveli i rrezikshmërisë	Gjedh	Kuaj	Dhentë e dhitë	Derra	Lepuj	Shpend
1.Shumë kritike	<150	<300	<300	<100	<100	<100
2.Kritike	250	500	500	200	250	250
3.Të rrezikuar	450	900	900	300	500	500
4.Në prag të rrezikut	750	1500	1500	500	1000	1000
5.Të parrezikuar	1500	3000	3000	1000	2500	2500

VENDIM
Nr.1709, datë 29.12.2008

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E MBROJTJES
BASHKISË SARANDË TË SIPËRFAQES 10 000 (DHJETË MIJË) M², PJESË E PRONËS NR.696
“BAZA NDIHMUESE”, SARANDË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË
18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 2, shkronja “c”, 5,7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 10 000 (dhjetë mijë) m², pjesë e pronës me numër rendor 696 “Baza ndihmuese”, Sarandë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi bashkisë së Sarandës, për t’u përdorur për zgjerimin e varrezave publike të qytetit.

2. Sipërfaqja 10 000 (dhjetë mijë) m², pjesë e pronës me numër rendor 696 “Baza ndihmuese”, Sarandë, sipas genplanit përkatës, të hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Sarandës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe bashkia e Sarandës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1710, datë 29.12.2008

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.502, DATË 16.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR ADMINISTRIMIN E KONVIKTEVE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5 të vendimit nr.502, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohen pikat 5.1 dhe 5.2, me këtë përmbajtje:

“5.1 Njësive të qeverisjes vendore, për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar, t’u shtohen, respektivisht, 151 punonjës edukativë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilët pakësohen nga numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Efektet financiare për këta punonjës të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të cilat të kalojnë si pjesë e grantit të pakushtëzuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore.

5.2 Punonjësit edukativë, që shtohen, të jenë me arsim të lartë për mësuesi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

DARZA	Numri i punonjësve në konvikte		
	Gjithsej	Zv.drejtor	Edukator
DAR Berat	7	1	6
ZA Skrapar	3	1	2
DAR Dibër	5	1	4
ZA Mat	4	1	3
DAR Durrës	7	2	5
DAR Gjirokastrë	8	2	6
ZA Tepelenë	2	1	1
ZA Përmet	3	1	2
DAR Fier	6	2	4
ZA Lushnje	3	1	2
DAR Elbasan	14	2	12
ZA Gramsh	2	1	1
DAR Korçë	10	3	7
ZA Kolonjë	3	1	2
ZA Lezhë	3	1	2
ZA Mirditë	8	2	6
DAR Kukës	4	1	3
ZA Has	2	1	1
ZA Kavajë	3	1	2
ZA Malësi e Madhe	1	1	
DAR Shkodër	20	4	16
ZA Pukë	4	1	3
DAR e qytetit Tiranë	22	7	15
DAR Vlorë	7	2	5
Gjithsej	151	41	110

UDHËZIM
Nr.23, datë 30.12.2008

PËR PËRMBAJTJEN E BONUSIT TË STREHIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Bonusi i strehimit jepet me vendim të këshilit bashkiak familjeve që kanë paraqitur, pranë zyrave përkatëse në bashki, kërkesën për strehim në një nga format që parashikon ligji nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, dhe kanë fituar pikët maksimale, sipas sistemit të pikëzimit që miratohet për këtë program. Bonusi i strehimit përdoret vetëm për pagesën e qirasë, sipas përcaktimeve të neneve 13,16 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar.

2. Bonusi i strehimit, si rregull, zbatohet në ato objekte banimi, për të cilat ka një marrëveshje paraprake midis pronarit dhe entit menaxhues, apo strukturës vendore të ngritur për menaxhimin e banesave sociale me qira. Për vitin e parë të zbatimit të këtij programi dhe deri në identifikimin e banesave në treg që mund të përdoren për bonus strehimi, këshillat bashkiakë miratojnë dhënien e bonusit për një objekt për të cilin nuk është lidhur marrëveshja si më sipër.

3. Në rastet e parashikuara në germenin “c” të nenit 13 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, si dhe në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij udhëzimi, kërkuesi i bonusit paraqet kërkesën pranë zyrave përkatëse në bashki për bonus strehimi, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi vendndodhjen e banesës ku ai kërkon të strehohet ose ku është i strehuar, masën e qirasë për të cilën ka nënshkruar ose do të nënshkruajë kontratë me pronarin e banesës dhe të ardhurat mujore familjare.

4. Kur banesa, ku do të strehohet ose është strehuar familja, që pretendon përfitimin e bonusit, është gjetur nga vetë familja, zyrat përkatëse në bashki bëjnë verifikimin në vend të ekzistencës së banesës, kushteve të banimit dhe qirasë që ofron pronari.

5. Pas miratimit nga këshilli bashkiak, përfituesit i lihen tre muaj kohë për të gjetur banesën në treg. Kontrata e qiradhënies lidhet mes pronarit të banesës dhe përfituesit të bonusit, sipas procedurave të Kodit Civil.

6. Afati i lidhjes së kontratës së qirasë nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 vit, përveç rasteve kur kjo është përcaktuar që më parë nga palët. Familja që ka përfituar bonusin e strehimit mund të dalë nga kjo skemë pas një viti, nëse vërtetohet që ajo ka zgjidhur problemin e strehimit, ose nëse të ardhurat e familjes janë rritur aq sa për të përballuar pagesën e qirasë pa nevojën e bonusit. Për të llogaritur nivelin e të ardhurave të familjes që del nga skema, bashkia zbaton formulën:

$A = Q_m \times 3$, ku A - janë të ardhurat mujore të familjes dhe Q_m është masa e qirasë minimale në treg, e përcaktuar sipas pikës 8 të nenit 2 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004.

7. Për familjet, që në përbërjen e tyre kanë një person me aftësi të kufizuara, apo një person me sëmundje kronike, si dhe për raste të tjera të ngjashme, këshilli bashkiak mund të miratojë një nivel më të lartë të ardhurash se ai i përcaktuar në pikën 6 të këtij udhëzimi.

8. Për llogaritjen e masës së bonusit, zyrat përkatëse në bashki i referohen nivelit të të ardhurave mujore, të familjes dhe qirasë për të cilën është lidhur kontrata. Shuma e bonusit të strehimit llogaritet sipas formulës:

$$\text{Ç} = Q - (A \times 0.3) \text{ ku}$$

Ç - është vlera e bonusit;

Q - është qiraja e ofruar nga pronari i banesës ose qiraja aktuale të cilën paguan familja, por jo më e larta se qiraja minimale;

A - janë të ardhurat mujore të familjes.

9. Këshilli bashkiak mund të miratojë një nivel më të lartë të bonusit të strehimit, kur projekti zbatohet me të ardhurat e bashkisë.

10. Shumat mujore të bonusit të strehimit, si rregull, i xhirohen qiradhënësit në llogarinë e tij bankare. Kryetari i bashkisë mund të zgjedhë një formë tjetër për realizimin e pagesave të bonusit, si p.sh. nëpërmjet postës ose zyrave që shpërndajnë ndihmën ekonomike.

11. Në fillim të çdo viti, apo sa herë që bashkitë fillojnë zbatimin e një programi të ri për dhënie bonusi për strehim, bëjnë njoftim publik për familjet që kanë paraqitur kërkesat pranë zyrave vendore. Familjet, të cilat kanë aplikuar për një program tjetër strehimi, nëse kërkojnë të strehohen nëpërmjet

bonusit, paraqesin kërkesë me shkrim në zyrat përkatëse në bashki.

12. Për çdo program të ri bonusi që fillon, zyrat përkatëse në bashki llogarisin buxhetin duke mbajtur parasysh shumën totale të bonusit të mbartur nga viti i mëparshëm për familjet që janë futur në këtë skemë, të cilat do të qëndrojnë edhe në vitin në vijim, plus buxhetin e nevojshëm për trajtimin e familjeve të reja.

13. Me qëllim rinovimin e së drejtës të përfitimit të bonusit të strehimit për vitin pasardhës, brenda një periudhe të përshtatshme përpara hartimit dhe miratimit të buxhetit vendor nga këshilli bashkiak, zyrat përkatëse në bashki bëjnë verifikimin e nivelit të të ardhurave të familjeve që kanë përfituar bonus strehimi. Verifikimi i nivelit të të ardhurave bëhet nga administratorët shoqërorë të zyrave të ndihmës ekonomike.

14. Bonusi e humbet vlefshmërinë kur:

- a) qiramarrësi bën deklaram të rremë për të ardhurat;
- b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;
- c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti apartamentin për të cilin ka lidhur kontratë dhe përfiton bonusin.

15. Zyrat përkatëse në bashki me disponimin e informacionit që vërteton njërin prej rasteve sipas germave (a) deri (c) mësipër, bën verifikimin dhe, nëse informacioni rezulton i vërtetë, njofton qiradhënësin dhe qiramarrësin për ndërprerjen e bonusit të strehimit.

16. Me humbjen e së drejtës të përfitimit të bonusit, zyra përkatëse në bashki njofton qiradhënësin. Marrëdhëniet mes qiramarrësit e qiradhënësit u nënshtrohen parashikimeve të Kodit Civil.

17. Çdo subjekt që është miratuar për përfitimin e bonusit të strehimit, pajiset me një dokument, i cili përmban:

- a) masa sigurie, në mënyrë që të mos lejojë falsifikimin e tij;
- b) të dhëna mbi identifikimin e qiramarrësit;
- c) të dhëna mbi identifikimin e qiradhënësit;
- d) adresën e banimit aktual të qiramarrësit;
- e) adresën e banesës që jepet me qira;
- f) adresën e banimit të qiradhënësit, nr.telefoni apo çdo të dhënë tjetër që mund të shërbejë për të komunikuar me të në rast ndërprerje të bonusit;
- g) të dhëna të mjaftueshme për të kontaktuar me qiramarrësin;
- h) shumën e bonusit që përfiton qiramarrësi në muaj;
- i) vitin apo periudhën gjatë të cilit është i vlefshëm bonusi;

j) si dhe kujtesa të detyrimeve kryesore që ka qiramarrësi ndaj bashkisë, për efekt të përfitimit të bonusit.

Një format orientues i dokumentit jepet bashkëlidhur.

18. Për efekt të identifikimit të banesave që mund të përdoren për programin e bonusit të strehimit, zyrat përkatëse në bashki bëjnë njoftim publik, në të cilin parashtrojnë kërkesat që duhet të përmbushë banesa, kohëzgjatjen e marrëveshjes, nivelin maksimal të qirasë, shumën e bonusit që mund të përfitojë pronari, si dhe kërkesa të tjera që çmohen të nevojshme.

19. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

STEMA E
BASHKISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia _____

Bonus strehimi

Ky bonus strehimi i jepet nga bashkia znj./z _____, miratuar me vendim nr. _____ datë _____ të këshillit bashkiak	
1) znj./z _____ duhet të gjejë një banesë me qira brenda 3 muaj nga data e marrjes në dorëzim të këtij dokumenti.	6) Përfituesi detyrohet të bëjë pagesën e diferencës së qirasë, sipas kontratës së qiradhënies që ka lidhur me qiramarrësin.
2) Vlera totale vjetore e bonusit është _____ lekë (në shifrat) _____ lekë (në fjalë)	7) Detyrimet e mirëmbajtjes së banesës janë në ngarkim të _____ (vendoset subjekti sipas kontratës). Bashkia nuk merr përsipër detyrime për mirëmbajtjen e banesës apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve kontraktuese që nuk respektojnë detyrimet kontraktuale.
3) Vlera mujore e bonusit është _____ lekë (në shifra) _____ lekë (në fjalë)	8) Vlera e bonusit të strehimit mund t'i xhirohet qiramarrësit në rast se të dyja palët kontraktuese bien dakord me akt noterial.
4) Shuma e këtij bonusi përfitohet çdo muaj. Data e vlefshmërisë së bonusit fillon më ____/____/____, dhe mbaron më ____/____/____.	9) Çdo përdorim i bonusit për qëllime të tjera përveçse asaj për të cilën është miratuar, përbën shkelje dhe personit që e ka përfutur, përveç sanksioneve sipas ligjeve në fuqi, i hiqet e drejta e përfitimit të çdo lloj mbështetjeje për strehim nga bashkia _____
5) Shuma e bonusit të strehimit i xhirohet pronarit të banesës në bankën _____, numër llogarie _____ çdo datë ____ të muajit. Nëse kjo datë bie në ditët e pushimit, pagesa kryhet ditën e parë të punës pas ditës së pushimit.	

KRYETARI I BASHKISË

Shënim:

Pikat 1,2,3 e 4 plotësohen nga zyra përkatëse në bashki, pas disponimit të listës emërore të miratuar nga këshilli bashkiak.

Pika 5 plotësohet pasi është nënshkruar kontrata e qiramarrjes mes qiramarrësit e qiradhënësit.

VENDIM
Nr.29, më 29.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 29.12.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e bërë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese zotit Gjergj Sauli.

BAZA LIGJORE: Neni 127, pika 1/c dhe 2 të Kushtetutës; neni 9 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.”.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatimin e bërë nga Kryetari dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Zoti Gjergj Sauli, me dekretin nr.3020, datë 21.5.2001 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për një periudhë kohe prej 9 vjetësh.

Sipas nenit 127 pika 1/c të Kushtetutës, mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur mbush moshën 70 vjeç. Zoti Gjergj Sauli është i datëlindjes 27.12.1938. Pra, në datën 27.12.2008 ai mbushi moshën 70 vjeç dhe, për rrjedhojë, po në këtë datë i mbaron mandati i gjyqtarit të kësaj Gjykate. Në pikën 2 të nenit 127 të Kushtetutës përcaktohet se mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të saj.

Ndodhur përpara këtyre rrethanave ligjore dhe faktike, Gjykata Kushtetuese çmon se mandati për zotin Gjergj Sauli duhet të deklarohet i mbaruar për shkak të mbushjes së moshës. Meqenëse vendi i tij mbetet vakant, Presidenti i Republikës, në bazë të nenit 127 pika 3 të Kushtetutës emëron, me pëlqimin e Kuvendit të Shqipërisë, një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit Gjergj Sauli, që përkon me datën 21.5.2010.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe neneve 9, 26, 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë zotit Gjergj Sauli, sepse ka mbushur moshën 70 vjeç.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

KËRKESË
Nr.8719/1, datë 30.12.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Korçë, Loti II”

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 14 905 110 (katërmëdhjetë milionë e nëntëqind e pesë mijë e njëqind e dhjetë) lekë.

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR “UNAZA KORÇË, LOTI II”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kad.	Nr.i pas.	Tokë arë			Tokë truall			Vlera totale (lekë)	Shënime
						Sip.m ²	Çmimi l/m ²	Vlera/lekë	Sip m ²	Çmimi l/m ²	Vlera (lekë)		
1	Gabriel		Heqimi	8561	9/3				246	18737	4609302	4609302	Konf.ZVRPP (bashkëpronësi)
	Petrit		Heqimi										Konf.ZVRPP (bashkëpronësi)
	Kleri		Heqimi										Konf.ZVRPP (bashkëpronësi)
2	Irfan		Kamenica	8561	9/73	23	416.6	9581.8				9581.8	Konf.ZVRPP
3	Ilia		Pavlo	8561	9/16				34	18737	637058	637058	Konf.ZVRPP (bashkëpronësi)
	Pavlo		Pavlo										Konf.ZVRPP (bashkëpronësi)
4	Maqo		Çifligu	8561	9/109	32	416.6	13331				13331	Konf.nga ZVRPP
5	Mustafa		Beli	8561	9/108	35	416.6	14581				14581	Konf.nga ZVRPP
6	Koço		Lubonja	8561	9/107	27	416.6	11248				11248.2	Konf.nga ZVRPP
7	Koço		Feçani	8561	9/123				36	18737	674532	674532	Konf.nga ZVRPP (Bashkpronësi)
	Pandush		Feçani										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Thanasaq		Feçani										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
8	Emilia		Gjergji	8561	9/124				79	18737	1480223	1480223	Konf.nga ZVRPP
9	Eleni		Mano	8561	9/2				18	18737	337266	337266	Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Zhorzheta		Mano										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Stela		Mano										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)

10	Avdyl		Kalemi	8561	9/81	35	416.6	14581				14581	Konf.nga ZVRPP
11	Avdyl		Kalemi	8561	9/114				89	18737	1667593	1667593	Konf.nga ZVRPP
12	Valter		Mema+bashkp	8561	9/36				96	18737	1798752	1798752	Konf.nga ZVRPP
13	Bektash	Adem	Pulaha+bashkp	8561	9/37				18	18737	337266	337266	Konf.nga ZVRPP
14	Bubulina		Zallemi	8561	9/148				3	18737	56211	56211	Konf.nga ZVRPP (Bashkëpronësi)
	Jolanda		Çipi										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Frida		Molla										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
15	Jolanda		Çipi	8561	4/118				4	18737	74948	74948	Konf.nga ZVRPP
16	Bubulina		Zallemi	8561	4/496				6	18737	112422	112422	Konf.nga ZVRPP
17	Liljana		Kiçollari	8561	9/130	5	416.6	2083				2083	Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Donika		Kiçollari										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Natasha		Kiçollari										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Suzana		Kiçollari										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Marjeta		Kiçollari										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Gjergji		Kiçollari										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
	Dhori		Kiçollari										Konf.nga ZVRPP (bashkëpronësi)
18	Pandeli	Vani	Façe	8561	3/901				45	18737	843165	843165	Konf.nga ZVRPP
19	Josif	Lifter	Kovaçi	8561	3/481				54	18737	1011798	1011798	Konf.nga ZVRPP
20	Artur	Pëllumb	Cenolli	8561	3/889				64	18737	1199168	1199168	Konf.nga ZVRPP
Totali						157		65406	792		14839704	14905110	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.1.2009
Doli nga shtypi më 22.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë